

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGETARE
"UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK.
TIRANE

VENDIMI NR 01 DATE 25.06.2013
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGETARE
"UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK TIRANE

Në Tiranë, sot në datën 25, muaji Qershor, viti 2013, u mbledh Ortaku i Vetem i Shoqërisë Tregtare "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK, në selinë e saj, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimin e veprimtarisë tregtare dhe treguesve financiarë të Shoqërisë Tregtare "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK, për vitin financiar 2012 si dhe ecuria e saj në të ardhmen;
- Miratimin e llogarive vjetore të Shoqërisë Tregtare "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK për vitin financiar 2012 të mbyllura me 31 Dhjetor 2012 dhe përcaktimin e fitimit të vitit ushtrimor 2012;
- Zmadhimin e Kapitalit Aksionar të Shoqërisë Tregtare "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK;

Ortaku i Vetem z. Luan MEMUSHI, pasi u njoh me rendin e ditës;

VËREN SE

Shoqëria Tregtare "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK, është regjistruar pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit në datën 11.09.2009, me Ortak të Vetem dhe Administrator z. Luan MEMUSHI.

Gjatë shqyrtimit të veprimtarisë tregtare dhe treguesve financiarë të Shoqërisë Tregtare "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK, Ortaku i Vetem konstaton se për të patur një vazhdimësi të veprimtarisë si dhe nisur nga aftësia paguese e mire, gjykon që fitimin e vitit ushtrimor 2012 ta kalojë për rezerva ligjore, rritje kapitali dhe për shpërndarje dividendi, në bazë të Statutit, Aktit të Themelimit „Ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, dhe dispozitave fiskale në fuqi.

Për këto arsye, Ortaku i Vetem i Shoqërisë tregtare "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK, pas shqyrtimit të rendit të ditës,

VENDOSI

- Miratimin e llogarive vjetore të Shoqërisë Tregtare "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK për vitin financiar 2012 të mbyllur me 31 Dhjetor 2012;
- Caktimin e fitimit të vitit ushtrimor 2012 për rezerva ligjore në vlerën 438,606 leke, për rritje të kapitalit në vlerën 3,400,000 leke dhe diferenca prej 16,117,302 leke për shpërndarje dividendi;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anëtar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar, me Nr. license profesionale 97 date 10.01.2001, për përgatitjen e raportit të vlerësimit për rritjen e kapitalit aksionar të shoqërisë "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK, Tiranë;
- Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË TREGETARE
"UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK -TIRANE
LUAN MEMUSHI

Luan Memushi
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGETARE
"UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK.
TIRANE

VENDIMI NR 02 DATE 19.07.2013
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGETARE
"UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK
TIRANE

Në Tiranë, sot në datën 19, muaji Korrik, 2013, u mbledh Ortaku i Vetem i Shoqërisë Tregtare "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK, në selinë e shoqërisë, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve të ushtrimit 2012 për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 18 Korrik 2013 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA;

Ortaku i Vetem i Shoqërisë, z. Luan MEMUSHI, pasi u njoh me rendin e ditës;

VËREN SE

Shoqëria Tregtare "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK, është regjistruar pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit me date 11.09.2009,

Ortaku i Vetem i kësaj shoqërie është z. Luan MEMUSHI. Kapitali aksionar i kësaj shoqërie është 8,600,000 (Tete milion e gjashtëqind mijë) Lekë. Kështu, z. Luan MEMUSHI zotëron 100 % të kapitalit aksionar, i barabartë ky me 1,000 (një mijë) kuota me vlerën 8,600,000 (Tete milion e gjashtëqind mijë) Lekë, ku secila kuotë ka vlerën prej 8,600 (Tete mijë e gjashtëqind) Lekë;

Me Vendimin Nr. 01, datë 25.06.2013, Ortaku i Vetem i Shoqërisë ka vendosur:

- Miratimin e llogarive vjetore të Shoqërisë Tregtare "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK për vitin financiar 2012 të mbyllur me 31 Dhjetor 2012;
- Caktimin e fitimit të vitit ushtrimor 2012 për rezerva ligjore në vlerën 438,606 leke, për rritje të kapitalit në vlerën 3,400,000 leke dhe diferenca prej 16,117,302 leke për shpërndarje dividendi;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anëtar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar, me Nr. license profesionale 97 date 10.01.2001, për përgatitjen e raportit të vlerësimit për rritjen e kapitalit aksionar të shoqërisë "UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK, Tiranë;
- Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit.

Në vështrim të rendit të ditës, Ortaku i Vetem i kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve të vitit ushtrimor 2012 për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 18 Korrik 2013, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Regjistruar z. Lavdimir FUSHA, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar.

[Signature]

Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit aksionar të shoqërisë bëhet nga 8,600,000 (Tete milion e gjashtëqind mijë) Lekë në 12,000,000 (Dymbëdhjetë milion) Leke, e barabartë kjo me 1,000 (Një mijë) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 12,000 (Dymbëdhjetë mijë) Lekë. Pra, numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar mbetet i pandryshueshëm dhe vetëm vlera nominale e tyre rritet.

Ky kapital do të zotërohet nga Ortaku i Vetem në këtë mënyrë:

z. Luan MEMUSHI, do të jetë përsëri zotëruar i 100 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 1,000 (Një mijë) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 12,000 (Dymbëdhjetë mijë) Lekë.

Për këto arsye, Ortaku i Vetem, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

VENDOSI

- Miratimin e Raportit të Ekspertit për vlerësimin e fitimeve të vitit ushtrimor 2012 për zmadhimin e Kapitalit Aksionar të Shoqërisë të datës 18 Korrik 2013 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Regjistruar;
- Zmadhimin e Kapitalit Aksionar të kësaj shoqërie nga 8,600,000 (Tete milion e gjashtëqind mijë) Lekë në 12,000,000 (Dymbëdhjetë milion) Leke, e barabartë kjo me 1,000 (Një mijë) kuota (pjesë) kapitali;
- Numeri i kuotave (pjesëve) të kapitalit, mbetet i pandryshueshëm, dhe rritet vetëm vlera nominale e tyre;
- Vlera e çdo kuote (pjesë) kapitali kalon nga 8,600 (Tete mijë e gjashtëqind) Lekë në 12,000 (Dymbëdhjetë mijë) Leke;
- z. LUAN MEMUSHI, do të jetë përsëri zotëruar i 100 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 1,000 (Një mijë) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 12,000 (Dymbëdhjetë mijë) Lekë;
- Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË TREGETARE

"UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANES" SHPK TIRANE

LUAN MEMUSHI

Luan Memushi
[Signature]

